



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:094490
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05653588

Ac.nr.2614/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit B.T. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.O., avokat në Prizren, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës” (Te Terminali Doganor) pn., Magjistralja Prishtinë - Fushë Kosovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson M.P., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.425/18, datë 09.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës” (Te Terminali Doganor) pn., Magjistralja Prishtinë - Fushë Kosovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.425/18 i datës 09.12.2019, në pikën I dhe III, të dispozitivit, VERTETOHET.

II. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II dhe IV, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.425/18, të datës 09.12.2019, ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.T. nga Prizreni, ashtu që: Obligohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të paguaj shumat si në vijim:

a). Dëmi jo material:

- Për dhimbje fizike (trupore) për të gjitha format shumë prej 3.300.00 €
- Për frikë shumë prej 2000.00 €
- Në emër të vuajtjeve shpirtërore për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 13% shumë prej 4200€
- Në emër të shëmtimit të shkallës së mesme 1.500.00 €

b). Dëm material:

- Për ndihmë dhe kujdes të huaj për 6 jave 420.00€
- Për ushqim të përforcuar shumë prej 490.00€

Për shpenzimet e shërimit, sipas dëftesë pagesave dhe kuponëve 40.00€

Gjithsej në emër të dëmit material dhe jo material obligohet e paditura ti paguaj paditësit shumë prej 11.950 €), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga data e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

- II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë e kërkuar nga paditësi përtej shumave të aprovuara si në dispozitiv nën I, të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material si dhe pjesa e kërkesëpadisë e cila ka të bëjë me shpenzimet në emër të rehabilitimit fizioterapeutik klimatik, në emër të veshmbathje dhe atë deri në shumë prej 19.100 € refuzohet si e pabazuar.
- III. OBLIGOHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguaj paditësit shumë prej 1.341,40€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën ekzekutim të përmbartimit të dhunshëm.
- IV. Pjesa tjetër e shpenzimeve procedurale, mbi shumë e aprovuara sikurse në dispozitivin III, të këtij aktgjykimi e deri në shumë prej 1,476.60 €, refuzohet si e pabazuar.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit, apo lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 26.03.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës, të

precizuar si në parashtrësën e datës 30.08.2019, me të cilën ka kërkuar që të: Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.T. nga Prizreni, Obligohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, që të bëjë pagesën në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial dhe atë: për dhimbje fizike shumë prej 4.800 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 5.500 €, për frikë shumë prej 3.000 €, për shëmtim shumë prej 2.000 €, për ndihmë të huaj shumë prej 500 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 500 €, për rehabilitim klimatik shumë prej 1.600 €, për shpenzimet e mjekimit shumë prej 1.000€, për veshmbathje shumë prej 200 €, në shumë totale prej 19.100 €, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8% nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë e përgjithshme prej 1.476.60 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.425/18, i datës 09.12.2019, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsytim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka parashtruar se për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore ka bërë administrimin e këtyre provave: leximin e ekspertizës mjeko-ligjore psikiatrike të ekspertit Dr. Naim Fanaj të datës 28.05.2019; ka bërë dëgjimin e ekspertit të psikiatrisë Dr. Naim Fanaj si dhe ekspertës së ortopedisë Dr. Vjollca Binçe në shqyrtimin kryesor të datës 27.08.2019; ka bërë leximin e raportit të policisë të datës 19.04.2017 vërtetimit të lëshuar nga Prokuroria Themelore në Prizren PPP.nr.712-7/17 të datës 22.09.2017; raportit specialistik të lëshuar nga Spitali Rajonal në Prizren me nr.3768 të datës 19.04.2017; raportit të lëshuar nga Klinika Universitare me nr.15103 datë 19.04.2017; ka bërë leximin e fletshënimit nga QKUK në Prishtinë-Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale me nr.2004/2017 të datës 28.04.2017; raportit mjekësor të specialistit Dr. Enver Ibrahimit të datës 09.12.2017; raportit të Dr. Xhemajl Selmani të datës 13.12.2017; përgjigjes së Prokurorisë Themelore në Prizren me nr. të lëndës PPP/II..nr.712-7/17 të datës 09.10.2019. Pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka konstatuar se baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar nga provat shkresore nga të cilat është konstatuar se paditësi si këmbësor, me datë....., në rrugën në Prizren është goditur nga automjeti i paidentifikuar, si pasojë e pakujdesisë së drejtuesit të automjetit dhe mospërshtatjes së shpejtësisë, kushteve dhe rrethanave të rrugës, prandaj përgjegjësia për kompensimin e dëmit në këtë rast sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia bie mbi të paditurën.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material dhe jomaterial, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë të provës ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Vjollca Binçe ortoped - traumatolog dhe Dr. Naim Fanaj psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në ekspertizën mjekësore të datës 28.05.2019 dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 27.08.2019, kanë konstatuar se paditësi si pasojë e këtij aksidenti, ka pësuar këto lëndime trupore frakturë e qafës së nofullës së poshtme në të dy anët, frakturë e trupit të nofullës së poshtme të anës së majtë, plagë shqyese në buzën e poshtme, humbje të dhëmbit 11, 21, 22, 24, plagë shqyese në regjionin e mjekrës dhe thyerje e qafës së krahut të djathtë, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuar, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 1 orë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditësh, të intensitetit të mesëm 28 ditë, të intensitetit të ulët vazhdon edhe sot e kësaj dite. Paditësi ka zvogëlim të aktivitetit të

përgjithshëm jetësor në shkallë prej 13.5 %, për shkak të lëvizjes së krahut të djathtë të shkallës së lehtë. Shëmtim trupor të shkallës së mesme pasi i ka humbur 4 dhëmbë të përparme dhe për shkak të vrazës së mbetur pas qepjes në regjionin e mjekrës me gjatësi 4 cm. Ndihma e personit të tretë në kohëzgjatje prej 6 javë, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 javë. Terapia fizikale ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 2 javësh në vitin e parë dhe dy javë në vitin e dytë pas aksidentit. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 1 muaj dhe frikë sekondare me intensitet të ulët që ka vazhduar edhe sot e kësaj dite.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese mbi shumat e aprovuara, gjykata ka parashtruar se shumat e kërkuara me kërkesëpadi përtej shumave të aprovuara, nuk janë reale dhe se të njëjtat nuk i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë deliktore civile të të paditurës. Njëherit gjykata e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit e cila ka të bëjë me shpenzimet e rehabilitimit fizioterapeutik dhe shpenzimet lidhur me veshmbathjen ngase gjeti se paditësi nuk ka provuar me prova se ka realizuar lidhur me këto shpenzim e për të cilat në kuptim të nenit 319.1 të LPK-së, ka qenë i detyruar t'i provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave nga neni 136, 137, 140, 159, 174, 179 dhe 183 paragraf 1 dhe 2 të LMD-së, neni 20 paragraf 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, (LSDA) lidhur me neni 143 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së. Për kamatën gjykata ju ka referuar neni 382 paragraf 1 dhe 2 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në neni 452 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe, në kuptim të nenit 194 të LPK-së Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së, për arsye se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes me aktgjykimin e atakuar, nuk ka tejkallur kërkesëpadinë e paditësit, por e njëjta ka vendosur brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditësit, të precizuar si në parashtrësën e datës 30.08.2019, siç përcaktohet me neni 2 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të propozuara nga vetë palët ndërgjyqëse, e të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata. Rrjedhimisht, me zbatimin e drejtë të drejtës materiale gjykata ka vendosur për aprovimin e pjesërisht të kërkesëpadisë,

duke e detyruar të paditurën që paditësit në emër të dëmit të shkaktuar nga automjeti i pidentifikuar, t'i shpërblej dëmin material dhe jomaterial në shumën e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Me vlerësimin e shkresave të lëndës, raportit policor rezulton se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë rreth orës ... minuta, në Prizren në rrugën "...", përkatësisht në drejtim të rrugës "..." me të arritur përballë shitores "..." në Prizren. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë "...", ngjyrë e zezë, ku ngasësi i automjetit nuk ka mund të identifikohet, pasi që i njëjti është larguar nga vendi i ngjarjes, ashtu që si pasojë e vozitjes së pakujdesshme dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë kushteve dhe rrethanave në rrugë e godet këtu paditësin në cilësinë e këmbësorit i cili në atë moment ishte duke kaluar rrugën në anën e majtë. Këtu paditësi nuk ka përgjegjësi në shkaktimin e këtij aksidenti, ndërsa në anën tjetër shkaktari i aksidentit nuk është identifikuar, ashtu siç rezulton edhe nga përgjigja e Prokurorisë Themelore në Prizren PPP/II nr. 712/2017, datë 09.10.2017, se në rastin konkret nuk është ngritur aktakuzë, përkatësisht çështja ka ngelur e papërfunduar deri në momentin e identifikimit të kryerësit të veprës penale. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët. E paditura, gjatë shqyrtimit kryesor në shkallë të parë, nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor. Në raport me faktet e rastit gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat e ligjit material, pasi baza juridike e kërkesëpadisë gjen mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet si dhe në dispozitat e nenit 20 të LSDA.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkellje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jo material për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shumica e gjykuar është në ekuivalencë me të mirën e cenuar, duke siguruar që kompensimi të shërbej si satisfakcion për paditësin. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jo material sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor të cilët kanë konstatuar se paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të konstatuara si më lartë, po ashtu kanë konstatuar se paditësi ka shkallë të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 13.5 %, shëmtim trupor - shkalla e mesme e shëmtimit, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimit e lartësisë, siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shkallën e shëmtimit trupor si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së.

Poashtu, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me kompensimin e dëmit material: ushqimin e përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: "Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit". Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova

konkrete materiale. Kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjersa është konstatuar se në këtë rast paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të huaj prej 6 javë dhe ushqim të përforcuar në kohëzgjatje 10 javë, të njëjtit i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kriteret orientuese, rezultojnë se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve ju njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdes nga personi i tretë. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale, në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për shpenzimet e shërimit, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse baza juridike për këto kategori të dëmit gjen mbështetje në nenin 179 të LMD-së. Në këtë rast palës paditëse si pasojë e aksidentit i janë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera e lartësia e tyre është vërtetuar me prova në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 09.12.2019, e deri në pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika II dhe IV, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2614/20, me datë 19.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli